

**STATUTI**  
**I SHOQERISE' ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"OUTOMA" SH.P.K..**

Sot ,me 07/12/2020 , ne baze te Kushtetutes dhe te Kodit Civil ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, ne baze te ligjit ne fuqi Nr7512 ,date 08.10.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private Sipermarrjeve te lira dhe aktiviteve private dhe privatizimit" te ligjit N.9901 ,date 14.04.2008, "Per marrredheniet tregtare" dhe ne baze te ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007. Per qendren kombetare te regjistrimeve" ,qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare,me vullnetin e tyre te lire ortaket e shoqerise:

**ALBANIA INVESTIMENTI Sh.p.k.**, me seli ne Tirane, Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit",Pallati 68,Hyrja 10,Apartamenti 15, kapitali 10.000,00 leke e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit ne Tirane, NIPT L71503035T, perfaqesuar nga ortaku i vetem i shoqerise Z. Roberto Laera,lindur ne Bari ne Itali,me 07/06/1971 me nr identifikimi CA65038AD.

**Z. ALBANO GJECI** lindur ne FIER ne SHQIPERI ne 20/01/1970 me numer karte identiteti AY4658326 leshuar nga Komuna e Bitono-s(Ba) ne 30/11/2017.

**Z. GJERGJI GJECI** lindur ne FIER ne SHQIPERI ne 10/08/1967 me numer karte identiteti CA19691BQ leshuar nga Komuna e Bitono-s (Ba) ne 02/07/2018.

te cilet kane vendosur te hartohet statuti i nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar, aktiviteti i se ciles do te rregullohet mbi bazen e Legjislacionit Shqiptar aktual, sipas Akt Themelimit dhe Statutit te Shoqerise bashkangjitur.

**Neni 1 – Emertimi**

1.1 Emertimi i Shoqerise eshte **OUTOMA Sh.p.k.** (e cilesuar me poshte si "Shoqeria").

**Neni 2 – Forma Ligjore**

3.1 Shoqëria operon me seli ne adresen: Shoqëria operon me seli ne adresen: Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit", Pallati 68, Hyrja 10, Apartamenti 15.

3.2 Shoqëria mund te kete zyra, dego, perfaqesi dhe agjensi si brenda Shqiperise ashtu edhe jashte shtetit shqiptar.

3.3 Mbledhja e Orlakeve, mund te vendose, transferoje dhe/ose te mbylle, si brenda edhe jashte shtetit shqiptar, dege sekondare, filiale, seli, agjensi, zyra perfaqesimi dhe bashkesi lokale te cdo natyre.

#### **Neni 4 – Objekti**

Shoqëria ka si qëllim të saj të social çdo operacion të ligjshëm tregtar që përfshin, por nuk kufizohet, si në aktivitetet e renditura më poshtë:

- Zhvillimin, prodhimin, menaxhimin dhe tregtimin e montimit te dyerve, grilave, portave ,dritareve dhe sistemeve te sigurise per klientet.
- Prodhimi i pajisjeve të brendshme, të jashtme dhe të sigurisë. Zdrukhtari metal i për përdorim civil dhe industrial.
- Tregtia me shumicë dhe pakicë, si në formën tradicionale ashtu edhe në atë elektronike, importin dhe eksportin, me automjete të veta dhe / ose të palëve të treta, përfaqësimin me ose pa depozitë, të lëndëve të para, produkteve të gatshme ose gjysmë të gatshme, Produkte elektronike të konsumit dhe jo të konsumit,
- Kompjuterat dhe pajisje për teknologjinë e informacionit(informatike);
- Pajisje dhe veshje sportive; këpucë dhe artikuj prej lëkure;
- Produkte mekanike për transportin rrugor të njerëzve dhe mallrave, aksesorë dhe pjesë këmbimi për makina dhe motoçikleta, materiale konsumi, vajra lubrifikuese dhe jo-lubrifikuese;
- Goma për automjete bujqësore, për automjete dhe mjete pune, për transport njerëzish;
- Automjetet motorike dhe mjetet motorike, si me terheqje mekanike, si me terheqje elektrike, ashtu dhe hibride mekanike/elektrike;
- Motorë me djegie të brendshme, motorët elektrikë, pjesë këmbimi dhe pajisje për motorët me djegie të brendshme, pjesë këmbimi dhe pajisje për motorët elektrikë, grupe per furnizim me energji te pandërprere;
- Materiale ndërtimi: beton, pllaka, pajisje sanitare, materiale ndërtimore, produkte gjysëm të gatshme dhe jo të gatshme, pajisje,dritare, dyer,porta, llaç të veçantë për ndërtimet;
- Produkte per shtepite;

- Dru, lëndë drusore dhe produkte druri, të përpunuara, gjysëm të gatshme dhe të parafabrikuara;

Te gjitha produktet e prishura ose mykura ushqimore dhe jo, dhe te gjitha produktet jo ushqimore, produkte kimike(kimikate), detergjente, plehra për bujqësi dhe herbicide, produkte agrokulturore, si perimet, frutat, dritherat, ullinjtë, dhe derivatet e tyre, siç janë lëngjet e frutave, vererat, vajrat etj...,

Artikuj funerali dhe varrimi, si dhe pajisje shtesë prej metali, lidhjeve metalike dhe lidhjeve të përbëra.

- Blerja, shitja dhe shkëmbimi i tokës së ndërtimit, i ndërtesave në përgjithësi, i ndërtesave që do të restaurohen dhe rindërtohen ose do të shemben dhe rindërtohen;
- Blerja, shitja dhe shkëmbimi i apartamenteve, dyqaneve dhe depove industriale;
- Kryerja e nderimeve,ndertimet - civile, industriale, hekurudhore - riparime, rinovime, restaurime, të gjitha për llogari të shoqërisë dhe / ose për individët privatë ose organeve publike;
- Menaxhimi i pasurive të patundshme në pronësi dhe në emër të palëve të treta;
- Qiradhënia (me përjashtim të qirasë aktive) të pronave në pronësi;
- Tregtia me shumicë dhe pakicë, si dhe import-eksporti i automjeteve, makinave, makinerive për industrinë agro-ushqimore dhe të ndërtimit.

Shoqëria për arritjen e qëllimit të objektit të saj social,:

Mund të marrë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, interesa, kuota, aksione, përfshirë aksione në kompani të tjera, duke përfshirë dhe tipe konzorciumi, ndërmarrje të përbashkëta(joint venture), në shoqatat e përkohshme të kompanive dhe konsorciumeve dhe ndërmarrjeve me qëllime të njëjta dhe / ose të ngjashme për qëllime të investimeve të qëndrueshme, dhe jo vendosja me kusht që shkalla dhe objekti i pjesëmarrjes të mos ndryshojnë thelbësisht objektin e përcaktuar në statut;

Mund të marrë kredi dhe financime dhe në përgjithësi të përdor çdo formë të financimit me institucionet e kreditit, bankat, kompanitë ose individët, duke dhënë letrat me vlerë të përshatshme dhe garancitë e pasurive të patundshme, reale dhe personale.

## **Neni 5 – Kohëzgjatja**

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është vendosur deri më 31 dhjetor 2091 dhe mund të zgjatet.

## **Neni 6 – Kapitali**

6.1. Kapitali është 10.000 (dhjetë mijë ) leke i përbërë nga 3 (tre) kuota të barazvlefshme me vlerë nominale përkatesisht 5200 (pesë mijë e dyqind) leke të shoqërisë ALBANIA INVESTIMENTI, 2400 (dy mijë e katërqind) leke të Albano Gjeci dhe 2400 (dy mijë e katërqind) leke të Gjergji Gjeci.

6.2 Kapitali i shoqërisë është plotësisht i regjistruar dhe i lëshuar në mënyrë të mëposhtme:

- ALBANIA INVESTIMENTI zoteron 52%, (pesëdhjetë e dy përqind) të kapitalit aksionar i vlefshëm me 1 (një) kuota, të cilat korrespondojnë me 5200 (pesë mijë e dyqind) leke.
- ALBANO GJECI zoteron 24%, (njëzet e katër përqind) të kapitalit aksionar i vlefshëm me 1 (një) kuota, të cilat korrespondojnë me 2400 (dy mijë e katërqind) leke.
- Gjergji Gjeci zoteron 24%, (njëzet e katër përqind) të kapitalit aksionar i vlefshëm me 1 (një) kuota, të cilat korrespondojnë me 2400 (dy mijë e katërqind) leke.

#### **Neni 7 – Mundësia e transferimit të kuotave**

7.1 Kuotat sociale janë të transferueshme tek palët e treta në përputhje me dispozitat e akteve nënligjore të parashikuara në STATUT.

#### **Neni 8 – Administratorët**

8.1 Shoqëria mund të administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të lirë të veprojnë veçmas ose bashkarisht sipas asaj që do të vendoset në rastin e emërimit.

8.2 Administratorët nuk duhet të jenë medoemos edhe aksionerë dhe veprojnë në rolin e tyre derisa të japin dorëheqje ose shkarkohen nga Asambleja e Aksionerëve, ose për një periudhë tre-vjeçare (3) me mundësinë për t'u riemëruar.

8.3 Përfundimi i mandatit të Administratorëve hyn në fuqi në momentin kur emërohet organi i ri administrues.

8.4 Administratorëve u takon të përfaqësojnë Shoqërinë ndaj palëve të treta dhe në gjykim dhe kompetencat më të gjëra administrative, që mund të ushtrohen në harmoni me atë që përcakton artikulli 95 i ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" dhe ndryshime pasuese, por në çdo rast, brenda kufijve të përcaktuar në rastin e emërimit dhe nga ky Statut.

8.5 Administratorët mund të emërojnë prokure të veçantë për një akt ose një sërë aktesh.

8.6 Funkzioni administrativ kryhet sipas një tarife të parashikuar në ligj. Administratorëve u takon rimbursimin e shpenzimeve që kanë në lidhje me funksionin e tyre administrativ.

8.7 Me këtë akt themelimi vendoset si Administratorë i Shoqërisë:

Ledjona Sylyku lindur ne Berat me 20/03/1997 ne SHQIPERI bija e Nevili-it dhe numer dokumenti J75320061B.

### Artikull 9 – Gjuha

9.1 Ky Statut hartohet në gjashtë (6) kopje, tri (3) në gjuhën shqipe dhe tri (3) në gjuhën italiane.

9.2 Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin e këtij Statuti, versioni i tij në gjuhën italiane do të jetë i vetmi me vlerë të detyrueshme ligjor.

9.3 Ky akt miratohet në çdo artikull nga themeluesit e vetëm te Shoqërisë **OUTOMA Sh.p.k.** i cili nenshkruan me emrin, mbiemrin dhe firmën e vet të gjitha kopjet.

\*\*\*

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

ALBANIA INVESTIMENTI

ROBERTO LAERA

ALBANIA INVESTIMENTI Sh.p.k.  
ADMINISTRATORI  
Pr. Roberto Laera



ALBANO GJECI



GJERGJI GJECI

